



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN

Nr. 2303 Prot.

Elbasan, më datë 20/11/2021

“RREGULLORE”

"Mbi rregullat dhe kriteret e sigurisë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan "

Bazuar në Ligjin Nr. 98/2016. Nenit 38. pika “g” dhe nenit 49. në lidhje me përcaktimin e kriterëve dhe rregullave të sigurisë në Gjykatë, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 538. datë 03.07.2020, në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan,

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave standarde dhe të unifikuara për garantimin e rendit, sigurisë dhe lëvizjes së rregullt në ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. nga të gjithë përdoruesit e saj.

Neni 2
Fusha e veprimit

Kjo rregullore zbatohet për:

- a) Gjyqtarët e kësaj gjykate.
- b) administratën gjyqësore.
- c) palët në proçes,
- d) personat e thirrur në proçes.
- e) publikun dhe vizitorët.
- f) si dhe për çdo përdorues tjetër që hyn apo përdor ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Gjykata” - nënkupton Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan me të gjitha strukturat e saj funksionale dhe ndihmëse.
- b) “Ambient i gjykatës” - përfshin ambientet e brendshme të godinës dhe truallin funksional përreth saj, duke përfshirë hyrjet, hollin kryesor, sallat e gjykimit, zyrat administrative, hapësirat e pritjes, parkingun për automjete dhe çdo pjesë tjetër të përdorur në funksion të veprimtarisë së gjykatës.
- c) “Palë në proces” - çdo person fizik apo juridik, ose përfaqësues i personit juridik, në emër ose kundër të cilit zhvillohet gjykimi, sipas legjislacionit procedural në fuqi.
- d) “Përdorues i gjykatës” - çdo person që nuk është palë në proces, por që ka interes legjitim për akses në ambientet e gjykatës. Në këtë kategori përfshihen: përfaqësuesit e institucioneve publike, delegacionet vendase dhe të huaja, donatorët, organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit e mediave të akredituara, monitoruesit, studentët, praktikantët, publiku i përgjithshëm apo çdo përdorues tjetër i gjykatës.
- e) “Punonjës sigurie” punonjësit e ngarkuar për të garantuar rendin dhe sigurinë në ambientet e gjykatës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe udhëzimet e sigurisë fizike.
- f) “Hapësirë e përbashkët e gjykatës” - çdo hapësirë në të cilën është e lejueshme hyrja e publikut dhe e përdoruesve të tjerë, si p.sh sallat e gjykimit gjatë seancave publike, holli kryesor, korridoret, shkallët, hapësirat e pritjes dhe tualetet.
- g) “Hapësirë e veçantë e gjykatës” - çdo hapësirë në të cilën hyrja është e kufizuar dhe kërkon autorizim të posaçëm, si: zyra e kryetarit, zyrat e gjyqtarëve dhe kancelarit, arkivi, dhoma e serverit, ambientet për personat e ndaluar, të paraburgosur ose të dënuar, si dhe çdo hapësirë tjetër që nuk është e hapur për publikun.

Neni 4 Rregullat e Sigurisë

4.1 Sigurimi i ambienteve

Ndërtesa e Gjykatës ruhet nga punonjësit e sigurisë, me qëllim garantimin e rendit dhe sigurisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

4.2 Hyrja në godinë

- a) Hyrja e publikut në godinën e gjykatës realizohet vetëm nëpërmjet hyrjes kryesore, pas verifikimit të dokumentit të identifikimit nga punonjësi i sigurisë.
- b) Hyrja kryesore e godinës së gjykatës mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme nga një punonjës sigurie.
- c) Magjistratët, punonjësit e administratës gjyqësore dhe të prokurorisë, si edhe personat e autorizuar nga Kryetari i Gjykatës, hyjnë në godinë nëpërmjet një hyrjeje të veçantë.

- d) Hyrja e personave të ndaluar apo të arrestuar, të paraburgosurve ose të dënuarve të shoqëruar realizohet vetëm nëpërmjet hyrjes së veçantë të parashikuar për ta.

4.3 Hyrja e automjeteve

Hyrja e automjeteve në dispozicion të gjykatës, e automjeteve private të magistratëve, si edhe e mjeteve që transportojnë të akuzuarit nga institucionet e paraburgimit apo të dënuarit nga institucionet e vuajtjes së dënimit, realizohet nëpërmjet portave të veçanta të destinuara për këtë qëllim.

Në rastet veçanta mund të lejohen të hyjnë dhe automjete të tjera vetëm me autorizim paraprak të Kryetarit

Neni 5 Siguria në godinë

Rregullat bazë të sigurisë, që duhet të përmbushen në çdo gjykatë janë:

- Pajisja me detektorë elektronikë, të vendosur pranë hyrjes kryesore, për identifikimin e hyrjeve të paautorizuara;
- Vendosja e pajisjeve të testuara për fikjen e zjarrit në ambientet e godinës së institucionit përkatës si dhe instalimi i sistemit të alarmit të zjarrit;
- Pajisja e punonjësve të administratës së institucionit përkatës me mjete sigurie (çelësa, karta hyrjeje apo mjete të tjera të kësaj natyre), me qëllim realizimin e hyrjes nëpërmjet hyrjes së veçantë të godinës së institucionit;
- Pajisja me sistem kamerash vëzhgimi, si dhe me server për ruajtjen e këtyre të dhënave për një periudhë deri në dy muaj;
- Vendosja e sinjalistikës për vendkalimet e emergjencës që u mundësojnë personelit dhe publikut daljen e menjëhershme jashtë ndërtesës në raste urgjente;
- Informacioni i përmbledhur mbi rregullat bazë të sigurisë afishohet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të institucionit përkatës.

Gjykata përcakton personat përgjegjës që do të kenë akses në sistemet e kamerave, si dhe miraton rregulla specifike lidhur me përpunimin e të dhënave personale, në përpulhje me udhëzimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *"Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e videosurvejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera"*.

Neni 6 Punonjësi i sigurisë garanton rendin dhe sigurinë në:

- hyrjet kryesore dhe të veçanta të institucionit përkatës;
- portat e hyrjes së automjeteve dhe hapësirën e parkimit;
- sallat e gjyqit, nëse i kërkohet nga kryetari i seancës, në zbatim të urdhrave të dhëna prej tij;

- d) ambientet e tjera të brendshme, që përfshijnë kryesisht korridoret lidhëse pranë zyrave, si dhe hapësirat brenda perimetrit rrethues të godinës së institucionit përkatës.

Neni 7

Uniforma dhe identifikimi

Punonjësi i sigurisë mban uniformë të veçantë, me qëllim identifikimin e qartë nga publiku dhe pajiset me mjet identifikimi që përmban në mënyrë të dukshme, fotografinë e punonjësit, funksionin e tij dhe shenjën dalluese të subjektit që ofron shërbimin e sigurisë.

Neni 8

Detyrimi për mbajtjen e identifikimit

Punonjësi i sigurisë është i detyruar ta mbajë mjetin e identifikimit në një vend të dukshëm gjatë gjithë kohës së qëndrimit dhe ushtrimit të detyrës në ambientet e institucionit përkatës.

Neni 9

Kontrolli i sigurisë fizike

Punonjësi i sigurisë mund të kontrollojë hyrjet e godinës, automjetet dhe personat që dyshohen se përbëjnë rrezik për sigurinë e ambienteve, brenda një perimetri prej pesë (5) metrash rreth godinës së institucionit përkatës, duke filluar nga vija kufitare e objektit.

Neni 10

Procedura e verifikimit dhe e kontrollit të personave nga punonjësi i sigurisë

Procedura konsiston dhe kryhet si më poshtë:

- a) Kontrolli i identitetit të personave që hyjnë ose qëndrojnë në ambientet e institucionit, nëpërmjet verifikimit të dokumentit të identifikimit të këtyre personave;
- b) Në rast se personi që hyn nuk posedon asnjë dokument identifikimi, identiteti i tij mund të konfirmohet në një mënyrë tjetër të përshtatshme;
- c) Në rast se identiteti i personit nuk mund të konfirmohet, punonjësi i sigurisë nuk lejon hyrjen e tij në institucionin përkatës;
- d) Kontrolli fizik i personave që hyjnë, qëndrojnë ose largohen nga ambientet e institucionit përkatës, si dhe i sendeve që zotërojnë apo mbajnë me vete;
- e) Kontrolli mund të bëhet nëpërmjet këqyrjes, prekjes sipërfaqësore ose duke përdorur mjete të tjera të përshtatshme, si detektorët elektronikë.

Neni 11 **Regjistrimi dhe ruajtja e sendeve**

Procedura e regjistrimit dhe ruajtja e sendeve kryhet si më poshtë:

- a) Punonjësi i sigurisë ruan përkohësisht sendet e personit në vende të caktuara posaçërisht për këtë qëllim, me qëllim lehtësimin e hyrjes së personit në ambientet e institucionit;
- b) Regjistrimi i sendeve të mbajtura bëhet në forme të shkruar dhe nënshkruhet nga personi që posedon sendin;
- c) Personi, i cili kundërshton dorëzimin e sendit apo sendeve të ndaluara, nuk lejohet të hyjë në institucion;
- d) Punonjësi i sigurisë mban përgjegjësi për ruajtjen e sendit gjatë gjithë kohës që personi ndodhet në ambientet e institucionit përkatës, si dhe për kthimin e tij në momentin e largimit, me shënim dhe nënshkrim në regjistër.

Neni 12 **Sende të ndaluara**

Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, në ambientet e institucionit përkatës ndalohej mbajtja e sendeve të mëposhtme, pa u kufizuar vetëm në to, konkretisht si më poshtë:

- a) Armët, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për armët;
- b) Sendet të mprehta ose me majë (duke përfshirë brisket, gërshërët, kaçavidat ose çdo send tjetër të ngjashëm);
- c) Sprej për vetëmbrojtje;
- d) Pranga;
- e) Kafshë;
- f) Substanca narkotike ose psikotrope;
- g) Çdo mjet tjetër që mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe rendin në ambientet e institucionit.

Lista e sendeve të ndaluara, sipas pikës 7 të këtij kreu, afishohet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të institucionit përkatës.

Në rastet kur mbajtja me vete e sendeve të ndaluara përbën vepër penale, punonjësi i sigurisë autorizohet të ndalojë mbajtësin e tyre dhe të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Rregullat për sendet e ndaluara nuk zbatohen për:

- a) personat që mbajnë armë vetëm për shkak të funksionit dhe gjatë kryerjes së tij;
- b) sendet që përbëjnë prova materiale për qëllime gjyqimi.

Neni 14

Rregullat bazë të sigurisë në Gjykatë

Rregullat bazë të sigurisë që përmbushen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan janë :

- a. Siguracion i ndërtesës (zjarr, përmytje, tërmet);
- b. Pajisja me çertifikatë për Mbrojtjen Kundër Zjarrit (MKZ), nga ekspertë përkatës;
- c. Pajisja me detektorë elektronikë, të vendosur pranë hyrjes kryesore, për zbulimin e hyrjeve të paautorizuara;
- d. Vendosja e pajisjeve të testuara për fikjen e zjarrit në ambientet e godinës së institucionit përkatës, si dhe e sistemit të alarmit të zjarrit;
- e. Pajisja me mjete sigurie (çelësa, karta hyrjeje apo mjete të tjera të kësaj natyre) e punonjësve të administratës së institucionit përkatës, me qëllim realizimin e hyrjes nëpërmjet hyrjes së veçantë të godinës së institucionit;
- f. Pajisja me sistem kamerash vëzhgimi, paisja me sistem elektronik për lejimin e hyrjes në godinë, dhe si dhe me server për ruajtjen e të dhënave për një periudhë deri në dy muaj;
- g. Vendosja e vendkalimeve të emergjencës dhe e sinjalistikës përkatëse që mundësojnë daljen e shpejtë të personelit dhe publikut;
- h. Marrja e masave të nevojshme për furnizimin me energji elektrike në mënyrë të qëndrueshme dhe vendosja e gjeneratorëve në vende të sigurta.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore është e zbatueshme për trupën gjyqësore, administratën gjyqësore, çdo përdorues tjetër të Gjykatës dhe hyn në fuqi menjëherë me afishimin publikisht të saj pranë këndit të afishimit dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

KËSHILLI I GJYKATËS

ANËTARE
THOMAI DHA ROÇA



KRYETAR
ELIS DINE

ANËTAR
LEDIO SULKUQI